



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Mbështetje për Parlamentin
dhe Edukimin Qytetar në Shqipëri

PËRMIRËSIMI I SITUATËS TË NDIHMËSVE PERSONAL DHE PROGRESI I REFORMËS PËR VLERËSIMIN BIO-PSIKO-SOCIAL TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

PËRGATITUR NGA **SIDITA FORTUZI**,
EKSPERTE LIGJORE

MAJ 2022

PËRMBLEDHJE

A. NJOHJA E VITEVE TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË NDIHMESËS PERSONALE SI VITE PUNE

Legjislacioni dhe politikat që rregullojnë çështjet e ndihmës personal¹ në Shqipëri janë zhvilluar me ritme të shpejta, veçanërisht pas ratifikimit të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK). Kjo duke u bazuar edhe në peshën e madhe që KDKPAK i jep ndihmësve personal dhe rolin kyç që ata kanë në garantimin e jetesës së pavarur të personave me aftësi të kufizuara sipas saj.

Pavarësisht këtyre zhvillimeve, komuniteti i personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht ai i prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara mendore por edhe grupimeve të tjera, ka shprehur në mënyrë të vazhdueshme shqetësimin në lidhje me trajtimin e diferencuar, të padrejtë dhe të pajustificuar objektivisht në dispozitat ligjore të disa ndihmësve personal kundrejt të tjerëve. Kështu, në ndryshim nga kujdestarët (term i vjetër i zëvendësuar me termin 'ndihmës personal') e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, ndihmësit personalat të personave me aftësi të kufizuara të tjera, ku përfshihen personat me aftësi të kufizuara mendore (aftësi të kufizuara të shëndetit mendor dhe ato të sferës intelektuale), si për shembull persona me probleme të shëndetit mendor, autizëm, Sindromën Down, aftësi të kufizuara fizike të rënda/thella apo persona me dëmtime në shikim përfitojnë vetëm pagesë të ndihmës personal, por nuk përfitojnë sigurime shoqërore.

Vendimi Nr. 31, datë 20.01.2001 "Përfitimet nga Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik", ndryshuar me VKM Nr. 326, datë 12.03.2009 "Për disa shtesa në VKM Nr. 31, datë 20.01.2001 "Për Përfitimet nga Statusi i Invalidit paraplegjik/tetraplegjik"², për kujdestarët e personave paraplegjik dhe tetraplegjik, **periudhën e shërbimit si kujdestar, e vlerëson si periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni, barrë lindje, aksidenti në punë, sëmundje profesionale, dhe sigurimi shëndetësor**. Konkretisht, neni 4, pika 1 e këtij vendimi, përcakton se: "Periudha e shërbimit si kujdestar, për invalidin paraplegjik dhe tetraplegjik, i cili nuk është ekonomikisht aktiv, si dhe nuk përfiton të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, vlerësohet periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni, barrë lindje, aksidenti në punë dhe sëmundje profesionale, dhe sigurimi shëndetësor". dhe njëkohësisht edhe nga përfitimet që rrjedhin nga skema e sigurimeve shoqërore, si pensioni, barrë lindje apo sigurimi shëndetësor.³

Një parashikim i tillë mungon për persona, me lloje të tjera aftësish të kufizuara (të përmendura pak më lart). Edhe shoqëruarit për personat e verbër apo interpretët e gjuhës së shenjave mbeten të përjashtuar nga përfitimi i sigurimeve. Familjarët, kryesisht nënat, në raste tilla janë të detyruar që të mos punojnë dhe të përkujdesen në mënyrë të vazhdueshme për personat me aftësi të kufizuara, në veçanti për fëmijët. Këta familjarë nuk përfitojnë sigurime shoqërore, por përfitojnë vetëm pagesa si ndihmës personal. Duhet theksuar që në momentin kur komisionet përkatëse përcaktojnë nevojën për ndihmës personal për personin me aftësi të kufizuar, kjo nënkupton që aftësia e kufizuar e personit është e një shkalle të atillë e cila paraqet nevojë të vazhdueshme për ndihmë dhe përkujdesje. Duhet theksuar gjithashtu që legjislacioni nuk bën ndonjë dallim mes detyrave që kanë ndihmësit personal për persona me aftësi të kufizuara të ndryshme. Pavarësisht faktit se ndihmësit personal rregullohen në ligje e vendime të ndryshme, detyrimet ligjore që ata kanë kundrejt personave me aftësi të kufizuara janë të njëjta ose të tejet të ngjashme për të gjitha aftësitë e kufizuara.⁴

1 Para se të përdorej ky term, në legjislacionin që mbulon shërbimet sociale është përdoruar termi 'kujdestar', duke bërë ndryshimin përkatës me termin kujdestar ligjor. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Përfshirjen dhe Aksesueshmëri përdoret termi 'ndihmës personal'.

2 Në vendimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i njëjti vendim shfaqet me numrin 326.

3 Vendim Nr. 55, datë 29. 03. 2016 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ex-officio lidhur me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 618, datë 07.09.2006 "Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara".

4 Në rastet e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, dhe të verbër, legjislacioni që mbulon specifikisht çështjet e tyre nuk ka parashikime për përkufizimin apo detyrat e kujdestarëve. Por ato përfshihen në përkufizimin e ofruar në Vendimin Nr. 874.

Megjithatë, sigurimet shoqërore mbeten ekskluzivitet i ndihmësve personal të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Kjo ka shkaktuar një situatë diskriminuese kundër ndihmësve personal të personave të tjerë me aftësi të kufizuara të ndryshme nga personat para/tetraplegjikë dhe të cilët gjenden në kushte të njëjta ose të ngjashme me personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Nga ana tjetër kjo situatë shkakton edhe pabarazi në cilësinë e shërbimit që i ofrohet personave me aftësi të kufizuara të ndryshme nga ato të paraplegjisë dhe tetraplegjisë. Ky argumentim mbështetet edhe nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) i cili në një nga vendimet e tij⁵ sjell në vëmendje se, kohëzgjatja e përkujdesjes për një fëmijë të prekur nga autizmi apo Sindroma Down, është që nga koha e diagnostikimit dhe përgjatë gjithë jetës, për këtë arsye të paktën njëri prej prindërve të fëmijës duhet të kujdeset në mënyrë të vazhdueshme, duke hequr dorë nga e drejta për të punuar.

Mungesa e bazës ligjore e cila rregullon vetëm përfitimin e pagesës së kujdestarisë dhe jo përfshirjen në skemën e sigurimeve shoqërore, bën që ata të trajtohen ndryshe nga kujdestarët e personave paraplegjikë/tetraplegjikë, duke bërë që të humbin mundësinë për të punuar, dhe rrjedhimisht përjashtohen nga skema e sigurimeve shoqërore.⁶ KMD deklaroi që kjo situatë e krijuar ndër vite përbën diskriminim.

Në kuadër të këtij vendimi, KMD ka dhënë rekomandim për Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Shëndetësisë (tashmë MSHMS), të marrin masa dhe të bëjnë parashikimet e duhura ligjore, për kategorinë e kujdestarëve (ndihmësve personal) të personave të prekur nga autizmi apo Sindroma Down, për t'u njohur periudhën e shërbimit si kujdestar si periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni, barrëindje, aksidenti në punë, sëmundje profesionale, dhe sigurimi shëndetësor, me qëllim garantimin e mundësive të barabarta me kategorinë e kujdestarëve të personave paraplegjik/ tetraplegjik, në fushën e të mira dhe shërbimeve.

Në një rekomandim tjetër⁷ KMD ka konstatuar gjithashtu diskriminim në trajtimin e kujdestarëve të personave të verbër në krahasim me kujdestarët e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë për shkak të mungesës së parashikimeve ligjore për përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore. Në këtë rast KMD ka rekomanduar që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa sa më shpejt për plotësimin e kuadrit ligjor me qëllim njohjen e periudhës së shërbimit për të gjithë kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar.

Këto rekomandime nuk janë marrë parasysh akoma nga institucionet të cilave i drejtohen. Për më tepër, reforma në vlerësimin e aftësisë së kufizuar, ishte një mundësi e humbur nga ana e ligjhartuesve për të rregulluar situatën e ndihmësve personal. Në një nga vendimet⁸ që rregullojnë vlerësimin e aftësisë së kufizuar në zonat pilot ku kjo reformë po zbatohet përcaktohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuara, të rënda apo të thella, gëzojnë të drejtën e përfitimit të ndihmës personal ku kjo e drejtë përcaktohet nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar por edhe këtu mungojnë përfitimet nga sigurimet.⁹ Pra, edhe në kuadrin rregullator të reformës e cila ndër të tjera synon dhe një administrim më të mirë të përfitimeve për shkak të aftësisë së kufizuar, për ndihmës personal të personave që nuk kanë statusin e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë nuk parashikohen përfitime nga skema kontributive e sigurimeve.

5 Vendim Nr. 55, datë 29. 03. 2016 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ex-officio lidhur me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 618, datë 07.09.2006 "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara".

6 Ibid.

7 Rekomandim për përmirësimin e kuadrit ligjor me qëllim njohjen e periudhës së shërbimit si kujdestar i personit me aftësi të kufizuara, si periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni, barrëindje, aksidenti në punë, sëmundje profesionale, dhe sigurimi shëndetësor, për të gjithë kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar, më datë 07.12.2019.

8 Vendim Nr. 722, datë 11.11.2019 "Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre".

9 Këto komisione janë komisionet e reja të vlerësimit që janë ngritur në kuadër të reformës. Në rastet e tjera ku nuk zbatohet reforma veprojnë dhe përcaktojnë nevojën për ndihmës personal ato që njihen me emrin KMCA (komisionet mjekësore të caktimit të aftësisë për punë).

B. NIVELI I ULËT I PAGESAVE TË NDIHMËSVE PERSONAL

Një shqetësim tjetër është identifikuar në lidhje me nivelin e pagesës së ndihmësve personal. Këto pagesa janë të pamjaftueshme për të siguruar një shërbim dinjitoz të ndihmesës personale. Përfaqësues të organizatave të konsultuara deklarojnë që vetëm familjarë të afërt mund të ofrojnë një shërbim të tillë për një pagesë kaq të ulët dhe për më tepër pa sigurime shoqërore dhe pa orare të caktuara, por në mënyrë të vazhdueshme.

Sipas Vendimit Nr. 182, pagesa e ndihmësve personal është sa pagesa e personit me aftësi të kufizuara (që është 10 653 lekë¹⁰), me përjashtim të ndihmësve të personave paralegjikë dhe tetraplegjikë të cilët e kanë atë në masën 11 190 lekë. Ndhmësit personalë, që ofrojnë shërbim për më shumë se një përfitues, marrin një shtesë prej 50% të shumave përkatëse për çdo përfitues të shtuar.

Këto të ardhura janë krejtësisht të pamjaftueshme për të siguruar një jetesë dinjitoze në Shqipëri. Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë dhe Vendimi Nr. 874 parashikojnë disa detyra për ndihmësit personal, të cilat kërkojnë angazhim dhe përgjegjësi të cilat nuk justifikohen me një pagesë të tillë.

Ndërsa në zonat që preken nga reforma në vlerësim pagesat e ndihmësve personal është 120% (për të ashtuquajturat shërbime gjithëpërfshirëse) e pagesës bazë të aftësisë së dhe është 80% (për shërbime të herëpashershme) e pagesës bazë të aftësisë së kufizuar të rënda. Pagesa bazë për shkak të aftësisë së kufizuar është 150% e shumës së pensionit social, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar indeksohet sa herë indeksohet pensioni social.¹¹

C. ÇËSHTJE QË LIDHEN ME PROGRESIN E REFORMËS SË VLERËSIMIT BIO-PSIKO-SOCIAL DHE NDIKIMIN E SAJ TEK KOMUNITETI

Dokumenti politik "Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtjes sociale" është dokumenti bazë i cili ka përcaktuar parimet e reformës dhe zbatimit të saj, dhe në bazë të tij janë miratuar disa vendime që përbëjnë kuadrin rregullator të reformës. Reforma në vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara është realizuar për disa arsye: a) reflektimi i praktikës bashkëkohore ndërkombëtare të shndërrimit të vlerësimit mjekësor në vlerësim bio-psiko-social, për të reflektuar konceptin e ri të aftësisë së kufizuar si një ndërveprim të dëmtimeve funksionale të shkaktuara nga një sëmundje me faktorë psikologjikë e socialë; (b) rritja e efikasitetit të vlerësimit, duke krijuar mekanizmat administrativë që reduktojnë ndjeshëm shkallën e abuzimit, rrisin besueshmërinë dhe ulin koston e vlerësimit dhe (c) përmirësimi i shërbimit për qytetarët.¹²

Ky dokument lidhet me qëllimin strategjik të SKZHI "Konsolidimi i mbrojtjes shoqërore" dhe qëllimin politik 4.6.2 "Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara përmes vlerësimit bio-psikosocial, bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, **duke kombinuar skemën e pagesës Cash me shërbime të integruara**, për të arritur integrimin e tyre social dhe ekonomik".

Në lidhje me këtë reformë, komuniteti shpreh dy shqetësime kryesore. Së pari, bazuar në qasjen e integritetit të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara dhe pagesave Cash, komuniteti vëren që mungon skema e kombinuar e synuar e pagesave dhe shërbimeve pasi shërbimet ku komisionet e vlerësimit supozohet që do të orientojnë personat me aftësi të kufizuara janë në

10 Kjo pagesë indeksohet çdo vit, kështu që shuma është ajo e parashikuar në vendim por ka ndryshuar gjatë viteve të fundit në një masë të vogël.

11 Vendim Nr. 722, datë 11.11.2019 "Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësve personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre".

12 Dokumenti politik "Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtjes sociale"

numër të ulët dhe të pamjaftueshme. Shërbimet e ofruara janë gjithashtu të kufizuara në tipologji, duke mos mundur ciklin e plotë të shërbimeve për të cilat kanë nevojë personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu nuk janë të qarta ose mungojnë orientimet e komisioneve të vlerësimit në shërbime në të cilat supozohet që duhet të referojnë personat me aftësi të kufizuara në nevojë për to, si për shembull qendra, orët që duhet të marrin shërbimin, specialistët, shpeshhtësinë etj. Gjithashtu një shqetësim i cili përkon me gjetjet e disa studimeve¹³ është evidentimi i mungesës së një rrjeti efikas bashkëpunimi mes institucioneve që janë përgjegjëse për të trajtuar çështjet e aftësisë së kufizuar në nivel vendor (arsimi, shëndetësia, punësimi, formimi profesional, shërbimet sociale, strehimi, transporti dhe infrastruktura, organizatat që ofrojnë shërbime dhe organizata të personave me aftësi të kufizuara), çka e bën edhe më të vështirë orientimin drejt shërbimeve gjatë procesit të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Së dyti, një shqetësim tjetër i komunitetit ka të bëjë me transparencën e zbatimit të reformës në zonat e pilotuara. Nuk ka raporte të aksesueshme të monitorimit të reformës në mënyrë që të evidentohen arritjet dhe sfidat e kësaj reforme. Për rrjedhojë komuniteti nuk ka informacion në lidhje me ecurinë e saj dhe kjo pamundëson atë që të ketë pjesëmarrje efektive gjatë konsultimeve të ndryshme me institucionet e të japë sugjerime.

PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT

Ndihmësi personal është një term i përfshirë në legjislacionin shqiptar rishtazi në Ligjin për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë. Duhet theksuar që rregullimet për përfitimet e personave me aftësi të kufizuara janë të shpërndara në skema të ndryshme dhe legjislacioni është i fragmentuar e i shpërndarë në copëza të ndryshme ligjesh, vendimesh dhe rregulloresh. Për rrjedhojë edhe çështjet e ndihmësve personal trajtohen në skema të ndryshme, megjithëse përfitimet janë të përafërta ose të njëjta për të gjitha kategoritë e ndihmësve, me përjashtim të atyre me statusin paraplegjik dhe tetrapelegjik, të cilët dallojnë nga të tjerët sipas argumenteve si më sipër.

Në shërbimet për jetesë të pavarur (neni 6) në Ligjin për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë është parashikuar dhe asistencë (ndihmesa) personale. Në nenin 8 të këtij ligji parashikohet që ndihmësi personal ofron asistencën personale në cilësinë e ndihmësit për kujdesin personal, shoqëruesit (për personat e verbër), interpretin e gjuhës së shenjave (për personat që nuk flasin dhe nuk dëgjojnë) si edhe lehtësuesit për persona me aftësi të kufizuara në komunikim. Ligji përcakton që mënyrat e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmësit personal rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në këtë kuadër është miratuar Vendimi Nr. 874, datë 24.12.2019 "Për mënyrën e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmësit personal" i cili rregullon në mënyrë të detajuar çështjet e ndihmësit personal. Ky vendim, sikurse dikton vetë titulli, rregullon detyrat dhe përgjegjësit e ndihmësve persona, parimet e ofrimit të kësaj ndihmese, kriteret dhe procedurat që ndiqen për përzgjedhjen e ndihmësve personal.

Përveç ligjit dhe vendimit të përmendur më sipër, gjenden rregullime edhe në Ligjin për Asistencën Sociale.

Sipas këtij ligji, personat përfitues, që janë personat paraplegjikë dhe tetrapelegjikë, personat me aftësi të kufizuar, të cilët të cilët nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës sipas ligjit të sigurimeve shoqërore deklarohen të paaftë për punë të cilët, personat me aftësi të kufizuar, të deklaruar të tillë me vendim të Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar (nga reforma) përcaktohen se kanë nevojë për përkujdesje, përfitojnë edhe një ndihmë personal me pagesë.

13 Rama, R., (2016) "Analiza e situatës së shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara në Shqipëri" "Save the Children", Tiranë.; World Vision & ADRF (2018). Situation of implementation of services for children with disabilities at the local level: A guide to interventions aimed at improving the state of social and health services for the community of people with disabilities.

Në zbatim të ligjit është miratuar Vendimi Nr. 182, datë 26.2.2020 "Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmësit personal" i cili rregullon procedurat, nivelin e pagesave të ndihmësve personal, por edhe institucionet që përcaktojnë se në cilat kushte (mjekësore) personat me aftësi të kufizuara përfitojnë ndihmës personal.

Vendim Nr. 431, datë 8.6.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot parashikon në lidhje me ndihmësit personal, që personat me aftësi të kufizuara që kanë kufizime të rënda ose të thella të aftësive funksionale për të kryer veprimtari të jetesës së përditshme të përshtatshme për moshën dhe për të marrë pjesë në jetën sociale, ekonomike dhe politike të shoqërisë dhe ata që kanë nevojë për ndihmë për të kryer veprime bazike të lidhura me jetesën e përditshme dhe për pjesëmarrje në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike, sipas përcaktimeve të komisioni shumëdisiplinor të vlerësimit. Pagesat¹⁴ për shërbime të ndihmësit personal lidhen me pagesat për shkak të aftësisë së kufizuar dhe indeksohen çdo vit.

Vendim Nr. 722, datë 11.11.2019 "Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre" është një vendi tjetër i cili rregullon disa aspekte të ndihmësit personal, por ai i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë Vendimit Nr. 431 duke pasur të njëjtat parashikime.

REKOMANDIME

Në lidhje me problematikat e identifikuar si më sipër janë hartuar disa rekomandime për përmirësimin e situatës të ndihmësve personal dhe për reformën në vlerësimin bio-psiko-social të personave me aftësi të kufizuara.

- **Ndërhyrje në kuadrin ligjor për eliminimin e diskriminimit mes kategorive të ndihmësve personal.**

Kuadri ligjor duhet të plotësohet për të gjithë ndihmësit personal në lidhje me përfitimet nga skema e sigurimeve. Përfshirja ose jo në skemën e sigurimeve të ndihmësve dhe niveli i pagesës duhet të përcaktohen nga komisioni por kursesit të mos jetë e varur nga përkatësia në një status ligjor të personit me aftësi të kufizuara, por duhet të orientohen vetëm nga nevojat që ka personi me aftësi të kufizuara, nevoja të cilat nevojiten të përkthehen në orë punë, detyra dhe përgjegjësi të ndihmësve personal. Pra, orët e punës, detyrat dhe përgjegjësitë, shkalla e rëndesës së aftësisë së kufizuar duhet të lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë duhet të orientojnë pagesat e ndihmësve personal, si dhe përfitime të tjera sikurse janë përfitimet nga skema e sigurimeve.

Kjo mund të nënkuptojë në disa raste përshkallëzim të pagesave dhe kontributeve në skemën e sigurimeve. Ndërhyrjet në këto raste duhet të realizohen në tërësi dhe në të gjithë copëzat e legjislacionit që rregullon figurën e ndihmësit personal.

14 Më sipër është dhënë niveli i pagesave për ndihmësit personalat në zonat ku pilotohet reforma.

- **Reforma në vlerësim gjithashtu paraqet një mundësi shumë të mirë për të korigjuar trajtimin e padrejtë të disa ndihmësve personal kundrejt të tjerëve.**

Përfshirja e parashikimit për njohjen e viteve të shërbesës si ndihmës personal si vite kontributesh për efekt sigurimesh për personat që sipas vlerësimit të ri bio-psiko- sociale vlerësohen të shkallës së thellë dhe të rënduar do të ndikonte drejtpërdrejtë në vendosjen në një situatë trajtimi të barabartë, një përmirësim dhe trajtimi dinjitoz të ndihmësve personal.

Ndryshimi i qasjes në trajtimin financiar për ndihmësin personal dhe mënyrën e përcaktimit të pagesës për ofrimin e këtij shërbimi është një aspekt thelbësor që nevojitet të adresohet për të përmirësuar situatën e ndihmësve personal.

Qasja duhet të jetë e atillë që të mundësojë një punë dinjitoze për ndihmësit personal dhe këtu përfshihet trajtim financiar në formën e një page për punën e kryer (jo pagesa të pamjaftueshme sikurse ato ekzistuese), me kosto të mirëpërcaktuar për orë pune dhe në bazë të nevojave. Ky ndryshim në qasje duhet të përfshijë edhe ndihmësit personal të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët edhe pse mund të kenë trajtim më të favorshëm së sa grupime të tjera, sërish ky trajtim mbetet i pamjaftueshëm.

- **Zbatimi paralel i reformës në vlerësim me reformën e shërbimeve, duke garantuar realisht kombinimin e skemës së pagesës me atë të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.**

Shtrirja e reformës të vazhdojë me të njëjtën logjikë që të mund të sjellë ndikim real e të përmirësojë realisht jetën e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre.

- **Rritje e transparencës dhe pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave në procesin e reformës**

Komisionet e vlerësimit duhet të realizojnë plotësisht përgjegjësitë dhe detyrat që ata kanë në orientimin e personave me aftësi të kufizuara drejt shërbimeve duke siguruar transparencë të plotë për personat përfitues.

- Në lidhje me mungesën e informacionit në lidhje me progresin e reformës, sukseset dhe sfidat që ajo sjell, është e nevojshme që të publikohen raporte ose të ndahen gjetjet mbi reformën me komunitetin. Është e domosdoshme që ecuria e reformës të konsultohet në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive me komunitetin e personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave.



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim — IDM është një organizatë jo- qeveritare, e themeluar në nëntor të vitit 1999, që ka në fokus të veprimtarisë së vet qeverisjen pjesëmarrëse dhe institucionet demokratike, procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, zhvillimin e shoqërisë civile, bashkëpunimin rajonal dhe çështjet e sigurisë. Ne synojmë konsolidimin e zhvillimeve në këto fusha nëpërmjet hulumtimit të pavarur, rritjes së kapaciteteve dhe ndërveprimeve efikase përmes spektrit të gjerë të aktorëve në shoqëri.

Projekt i:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Zbatuar nga:



Shënim: Pikëpamjet dhe përfundimet që jepen në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe të NDI – Institutit Demokratik Amerikan. Autorësia e këtij botimi i përket vetëm IDM-së.